

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6264
E hënë, 15 mars 2021
çmimi 0.40 €

Kosova, pa asnjë gazetë të shtypur



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) KA MBAJTUR TË DIELËN KUVENDIN ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEN E LIDERIT TË RI

LUMIR ABDIXHIKU, KRYETAR I RI I LDK-së



Lumir Abdixhiku është zgjedhur kryetar i ri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Me 191 vota të 328 delegatëve të Kuvendit Zgjedhor të LDK-së, ai është bërë kryetari më i ri i këtij subjekti politik. Pas marrjes së

detyrës, Abdixhiku ka thënë se kjo parti po e hap një faqe të re të rrugëtimit politik. Në garën për kryetar të LDK-së me vota të fshehta, Abdixhiku ka mposhtur nënkryetarin e LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka marrë

116 vota dhe anëtarin e kryesisë të kësaj partie, Besian Mustafa, i cili ka marrë vetëm 16 vota të delegatëve. Të dy e kanë uruar Abdixhikun, duke i premtuar mbështetje në rrugëtimit politik

OPINION

A KISHTE DIJENI ENVER HOXHA SE VITI 1981 DO TË ISHTE NJËKOHËSISHT EDHE VITI I KRYENGRITJES SHQIPTARE? F. 10

Shkruan:
Bedri ISLAMI



AKTUALE

GJASHTË TË VDEKUR DHE 565 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 6

VRASJE DHE VETËVRASJE NË PRISHTINË F. 3

EKONOMI



SKËNDER THAÇI: QEVERIA E ARDHSHE TA KTHEJË VËMENDJEN KAH TURIZMI MALOR F. 9

MINISTRI NITAJ RIKTHEN NË PROCEDURË TË RREGULLT TENDERIN PËR EFIÇIENCËN E ENERGJISË F. 9

SPORT

DERBI NUK SOLLI FITUES, ISMET MUNISHI DEBUTON ME FITORË F. 12



KOSOVA HAP AMBASADËN NË JERUSALEM

Republika e Kosovës ka hapur zyrtarisht ambasadën në Jerusalem vetëm disa javë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me shtetin e Izraelit më 1 shkurt 2021. Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh ministër në Detyrë i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Besnik Tahiri, ka theksuar se hapja e ambasadës në Jerusalem është ndër çastet më të rëndësishme në shtetndërtimin e Kosovës

PACOLLI FTON DEPUTETËT QË TË HAPIN RRUGË PËR FORMIMIN E QEVERISË SË RE



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Premtimet e vonuara të BE-së dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor

BRUKSEL, 14 MARS - Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Oliver Varhelyi, ka thënë të premten se Bashkimi Evropian do të dëshironte të shihte më shumë dinamike në negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga blloku evropian në Bruksel. Ai i ka bërë këto deklarata në Forumin e Tretë Ekonomik, që është mbajtur në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë.

Ky forum është organizuar përmes videolidhjes për shkak të krizës shëndetësore të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit. Ai ka thënë se, si për Serbinë, ashtu edhe për Kosovën, është thelbësore që të shfrytëzohet mundësia aktuale për të bërë përparim në dialog. "Ky proces duhet të vazhdojë sapo të formohen institucionet

në Kosovë", ka deklaruar ai. Sipas Varhelyit, BE-ja pret bashkëpunim me Qeverinë e re të Kosovës, e cila duhet të formohet pas zgjedhjeve parlamentare të mbajtura më 14 shkurt të këtij viti, të cilat i ka fituar Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit. "Shpresojmë të shohim një stabilitet më të madh politik në periudhën e ardhshme, në mënyrë që Kosova ta përshpejtojë procesin e reformës, duke përfshirë sundimin e ligjit dhe zhvillimin socio-ekonomik", ka thënë ai.

Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, Varhelyi ka thënë se beson që Kosova ka përmbushur të gjitha kushtet për heqje të vizave. "Sidoqoftë, jo të gjitha vendet anëtare janë të bindura për këtë. Prandaj, ne u bëjmë thirrje autoriteteve të

Kosovës të kontaktojnë ato vende për ta rregulluar këtë gjë", ka thënë ai.

Në nivel të Ballkanit Perëndimor, Varhelyi ka thënë, në një panel të quajtur "Premtime të vonuara", se Bashkimi Evropian është zotuar se gjithë ky rajon do të jetë pjesë e bllokut evropian dhe se po punohet për ta përmbushur këtë gjë. Pjesë e panelit kanë qenë edhe zyrtarë nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Bosnje-Hercegovina. "Reformat shpesh kanë qenë të ngadalshme. Kjo është arsyeja pse disa vende të BE-së kanë vënë në dyshim thelbin e të gjithë procesit, dhe për këtë arsye nuk kanë rënë dakord ta shpejtojnë atë. Nga ana tjetër, shumë shpesh Bashkimi Evropian nuk ka arritur të japë përgjigje unanime



pozitive kur partnerët tanë të kenë sukses, t'i zbatojnë reformat e premtuara", ka deklaruar ai.

Komisionari për Zgjerim i

Bashkimit Evropian ka thënë se prioritet aktual i Brukselit është që të sigurojë vaksina për rajonin e Ballkanit Perëndimor sa më shpejt që është e mundur.

Protestë kundër masave të izolimit në Holandë

HAGË, 14 MARS - Policia në Holandë ka përdorur topa uji dhe shkopinj gome për të shpërndarë qindra protestues në Hagë të cilët po kundërshtojnë masat e izolimit, të vendosura për ta luftuar përhapjen e mëtejme të koronavirusit.

Protesta e së dielës në Hagë vjen vetëm një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme.

Policia ndërhyri kur protestuesit shkelën rregullat e mbajtjes së distancës fizike dhe injoruan thirrjet e autoriteteve të sigurisë që të shpërndahen.

Mediat lokale raportuan se policia ka ndaluar disa protestues.

Autoritetet ndaluan shërbimin e trenave në Hagë, për ta parandaluar arritjen e më shumë protestuesve.



Policia paralajmëroi protestuesit se nëse nuk shpërndahen, ata do të ndërhyjnë.

Holanda ka qenë nën masat e izolimit që prej fundit të

janarit dhe në këtë shtet është e ndaluar që të mblidhen më shumë se dy persona. Po ashtu, restorantet dhe baret janë mbyllur dhe gjatë natës aplikohet edhe kufizimi i

lëvizjes. Pavarësisht prej masave të rrepta kundër pandemisë, qytetarët holandezë do të votojnë në zgjedhje. Duke filluar nga e hëna do të hapen

vendotimet të cilat do të qëndrojnë të hapura për tre ditë, me qëllim që të mos ketë grumbullim të qytetarëve.

Partia e kryeministrit aktual holandez Mark Rutte po synon që të marrë edhe një mandat të ri katërvjeçar.

Shumica e qytetarëve holandezë përkrahin masat e izolimit, pasi ky shtet ka një ndër shkallët më të larta të infektimit në koronavirus në Evropë.

Por, masa e kufizimit të lëvizjes gjatë natës është zgatur deri në fund të marsit dhe kjo ka nxitur pakënaqësi të qytetarëve të cilët kanë mbajtur protesta në disa qytete holandeze.

Holanda, që ka popullsi prej 17 milionë banorësh, ka regjistruar mbi 1.1 milion raste me koronavirus dhe mbi 16 000 viktima.

Papa kërkon që të rriten përpjekjet për arritjen e paqes në Siri

VATIKAN, 14 MARS - Papa Françesku e ka cilësuar luftën civile në Siri si një prej krizave më të këqija humanitare në ditët e sotme, duke thënë se 10-vjetori i kësaj lufte duhet t'i shtyjë të gjithë që të kërkojnë "shpresë" për këtë shtet të shkatërruar. Ai bëri thirrje që të rriten përpjekjet për përfundimin e luftimeve. Protestat pro-demokracisë të

marsit të vitit 2011, shpejt u kthyen në konflikt të brendshëm, ku u përfshin edhe fuqitë botërore. Në këtë konflikt janë vlarë qindra mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur. "Sërish u bëj thirrje të gjitha palëve të përfshira në konflikt, që të tregojnë vullnet të mirë në mënyrë që të ketë një copëz shprese për popullsinë e lodhur", tha

Papa. Ati i Shenjtë tha se Siria ka parë "çdo lloj të dhunës dhe vuajtje nga popullata, veçanërisht nga shtresa më e ndjeshme siç janë fëmijët, gratë dhe të moshuarit".

Ai bëri thirrje për angazhim nga bashkësia ndërkombëtare, që të ndihmohet në dhënien fund të luftimeve dhe të nisat rindërtimi dhe rimëkëmbja ekonomike e Sirisë.



Kosova hap ambasadën në Jerusalem

Republika e Kosovës ka hapur zyrtarisht ambasadën në Jerusalem, vetëm disa javë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me shtetin e Izraelit më 1 shkurt 2021. Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh ministër në Detyrë i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës, Besnik Tahiri, ka theksuar se hapja e ambasadës në Jerusalem është ndër çastet më të rëndësishme në shtetndërtimin e Kosovës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 MARS - Kosova zyrtarisht ka hapur ambasadën në Jerusalem. E Ngarkuara me Punë e Republikës së Kosovës në Izrael, Ines Demiri, hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem e ka quajtur çast krenari dhe historik për marrëdhëniet mes dy shteteve. "Bazuar në marrëveshjen e Uashingtonit të 4 shtatorit 2020, ku zyrtarizohet njohja e ndërsjellë në mes të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Izraelit dhe zotimit të Qeverisë së Kosovës ndaj Qeverisë së Izraelit dhe administratës amerikane dhe veprimet që janë ndërmarrë nga 1 shkurti, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ju njofton se tashmë është hapur edhe zyrtarisht Ambasada e Kosovës në Shtetin e Izraelit, me seli në Jerusalem", ka njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës.

Gjatë ceremonisë së vendosjes së marrëdhënieve diplomatike më 1 shkurt 2021, ministri i Jashtëm i Shtetit të Izraelit, Gabriel Ashkenazi, bëri zbulimin e pllakës së Ambasadës së Republikës së Kosovës në Jerusalem. "Në pamundësi për të qenë të pranishëm në Jerusalem, përfaqësuesit e shtetit të Kosovës, për shkak të situatës pandemike, Ministria e Punëve të Jashtme ka udhëzuar të Ngarkuarën me Punë në Izrael që Pllakën e zbuluar nga ministri Ashkenazi, bashkë me flamurin shtetëror, ta vendosë në objektin e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem. Vendosja e pllakës dhe flamurit shtetëror në Ambasadën e Kosovës në Izrael reflekton përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për ta përmbushur zotimin e dhënë për vendosjen e misionit diplomatik në Jerusalem", ka njoftuar Ministria e Jashtme e Kosovës.

Në këtë njoftim është theksuar se Ambasada e Republikës së Kosovës në Jerusalem do të përkushtohet fuqimisht për ta rritur bashkëpunimin bilateral dhe për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës.

Tahiri: Hapja e ambasadës në Jerusalem, ndër çastet më të rëndësishme në shtetndërtimin e Kosovës

Zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh ministër në Detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Besnik Tahiri, të dielën, në një konferencë për media të organizuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, ka shpalosur qëndrimin e shtetit të Kosovës me rastin e hapjes së Ambasadës së Republikës së Kosovës në Shtetin e Izraelit, në Jerusalem. Ai ka theksuar se hapja e ambasadës në Jerusalem është ndër çastet më të rëndësishme në shtetndërtimin e Kosovës.

Kryediplomati Tahiri ka bërë me dije se që në fillim ky qëndrim nuk lidhet me ndryshim qeverish, është qëndrim shtetëror, dhe se të gjitha palët e kanë të qartë se njohja prej shtetit të Izraelit dhe hapja e Ambasadës në Jerusalem është një prej ngjarjeve më të rëndësishme në vitet e fundit. Më 4 shtator 2020 është nënshkruar marrëveshja e Uashingtonit në Shtëpinë e Bardhë mes presidentit Trump dhe kryeministrit të Republikës së Kosovës. Brenda marrëveshjes është përfshirë njohja reciproke në mes të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Izraelit. "Me arritjen e kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Kosovës ka dhënë zotimin para Qeverisë së Izraelit dhe asaj amerikane se do ta hapë Ambasadën e Republikës së Kosovës në Jerusalem", ka thënë



zëvendëskryeministri Besnik Tahiri.

Zëvendëskryeministri Tahiri ka pohuar se lidhja e këtyre marrëdhënieve diplomatike është realizuar pas shumë konsultimesh me Qeverinë e Izraelit, me administratën Trump dhe me administratën e re Biden.

Hoxhaj kritikon qeverinë në detyrë dhe atë në ardhje për mosprani në hapjen e ambasadës

Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, ka thënë se një qeveri në shkuarje dhe një qeveri në ardhje nuk patën guxim, as vendosmëri dhe përvojë për ta shënuar hapjen e Ambasadës së Kosovës në Izrael duke i lënë një shije të hidhur të gjithë procesit të njohjes ndërmjet dy vendeve tona. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se për disa javë autoritetet e larta të shtetit të Izraelit kanë pritur zyrtarisht koalicionin qeverisës dhe koalicionin fitues të zgjedhjeve për ta hapur ambasadën në Jerusalem, por askush nuk e ka

konfirmuar pjesëmarrjen. "Asnjëri nga zyrtarët e këtyre dy koalicioneve nuk është përgjigjur në letrat dhe thirrjet telefonike lidhur me këtë proces. Përkundrazi, të frikësuar, në panik dhe të papërgjegjshëm i kanë ikur pjesëmarrjes për një njohje shumë të rëndësishme të Kosovës. Kanë braktisur rolin e tyre kushtetues dhe politik që u takon për t'i përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e shtetit

tonë", ka thënë Hoxhaj. Ai ka shtuar se dykuptimësia e dobëson Kosovën, kurse qartësia strategjike e rrit kredibilitetin e saj ndërkombëtar. "Duke besuar se të tilla situata nuk do të përsëriten në të ardhmen, falënderoj ShBA-në dhe Izraelin për njohjen dhe fillimin e një kapitulli të ri ndërmjet shteteve, popujve dhe ekonomive tona", ka thënë Hoxhaj.

Haradinaj-Stublla: Shpifësit ma pamundësuan praninë në Jerusalem

Ish-ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka uruar hapjen e Ambasadës së Kosovës në Jerusalem. Haradinaj-Stublla ka shkruar se, pavarësisht prej pengesave të mëdha brenda e jashtë, ndihet e lumtur se kjo arritje u përmbyll. "Edhe pse shpifësit ma

pamundësuan kurorëzimin e kësaj pune me praninë time të planifikuar sot në Jerusalem, jam shumë e lumtur që, përkundër pengesave të mëdha brenda e jashtë, kjo arritje u përmbyll - duke hapur horizont të ri për Kosovën tonë", ka shkruar Haradinaj-Stublla në llogarinë e vet në "Facebook".

Vrasje dhe vetëvrasje në Prishtinë

PRISHTINË, 14 MARS - Në lagjen Emshir (Kalabri) të Prishtinës në mëngjesin e së dielës ka ndodhur një vrasje dhe një vetëvrasje. Policia ka

njoftuar se në orën 09:00 ka pranuar informacionin për gjetjen e dy personave të pajetë në Emshir të Prishtinës. "Viktimat, një

femër 44 vjeç dhe një mashkull 44 vjeç, shtetas kosovarë, kanë humbur jetën nga plagët e shkaktuara nga arma e zjarrit", ka

njoftuar policia, duke theksuar se në vendin e ngjarjes ka sekuestruar një revole, e cila dyshohet se është përdorur në këtë rast.

"Aktualisht po vijon puna hetimore për zbardhjen e plotë të motiveve dhe rrethanave të ngjarjes", ka njoftuar Policia e Kosovës.



LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) KA MBAJTUR TË DIELËN KUVENDIN ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEN E LIDERIT TË RI

Lumir Abdixhiku, kryetar i ri i LDK-së

Lumir Abdixhiku është zgjedhur kryetar i ri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Me 191 vota të 328 delegatëve të Kuvendit Zgjedhor të LDK-së, ai është bërë kryetari më i ri i këtij subjekti politik. Pas marrjes së detyrës, Abdixhiku ka thënë se kjo parti po e hap një faqe të re të rrugëtimit politik. Në garën për kryetar të LDK-së me vota të fshehta, Abdixhiku ka mposhtur nënkryetarin e LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka marrë 116 vota dhe anëtarin e kryesisë të kësaj partie, Besian Mustafa, i cili mori vetëm 16 vota të delegatëve. Të dy kanë uruar Abdixhikun, duke i premtuar mbështetje në rrugëtimit politik

t'u rikthyer. Dua të jem i qartë, ne i qëndrojmë prapa ideve të LDK-së", ka deklaruar Abdixhiku.

Para delegatëve të Kuvendit, ai ka lavdëruar dy kundërkandidatët, Hazirin dhe Mustafën, duke thënë se në garën për kreun e LDK-së kanë qenë shembull i kulturës politike. "Ju faleminderit nga zemra për besimin, përgjegjësinë dhe nderin dhënë sot. Në emër tuajin, falënderoj kryetarin e deritanishëm, akademik Isa Mustafa, që për 11 vjetët e fundit udhëhoqi shtëpinë tonë të përbashkët. Më lejoni t'i falënderoj edhe dy kundërkandidatët e mi, Lutfi Hazirin dhe Besjan Mustafën. Të dy me kulturën e tyre politike, origjinal me LDK-në, vendosën një garë demokratike si një shembull për të gjithë spektrin shqiptar", ka deklaruar Abdixhiku.

Më tej, ai ka premtuar reformë brenda LDK-së, duke u çuar edhe një mesazh të gjithë skeptikëve rreth kësaj partie. "Ndiej detyrë dhe përgjegjësi t'i prij kësaj detyre. Para një obligimi të tillë s'mund të qëndrojmë asnjëri indiferent. Rruga përpara kërkon shtyllat e mirëmbajtjes si parti e krahut të djathtë, filozofinë politike rugoviane. Rruga përpara kërkon afrimin e

njerëzve që më herët nuk kanë pasur vend. Rruga përpara kërkon reformë dhe reformë do të ketë. Skeptikët do t'i bindim se LDK-ja do të mbetet edhe Lidhje, edhe demokratike, edhe e Kosovës. Zoti e bekoftë Kosovën! Zoti e bekoftë LDK-në!", ka deklaruar Abdixhiku.

Kundërkandidatët pranojnë humbjen

Kryetari i ri i LDK-së urimet e para i ka marrë nga kundërkandidatët. Lutfi Haziri dhe Besian Mustafa kanë deklaruar se do t'i qëndrojnë prapa Abdixhikut. Para delegatëve, kryetari i Gjilanit dhe nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se kjo parti ka dëshmuar se është standard politik me zgjedhjet e sotme brenda partisë. "Sot ju dëshmuat se të gjitha ato vlerësime kanë rënë përtokë. LDK-ja është më e madhe, është standard politik dhe është shkollë politike. Është vetë shteti i Kosovës për të cilin kemi punuar pa u ndalur. Kryetari më i ri i skenës politike e rinon LDK-në", ka thënë Haziri.

Kurse kandidati tjetër për kryetar të LDK-së, Besian Mustafa, ka thënë se do të jetë një ushtar i tij në rrugëtimit politik. "Lumir, urime dhe suksese! Nga sot mua, Lutën dhe të gjithë anëtarët e LDK-së na

ke ushtarë të këtij misioni", është shprehur Mustafa.

Mbajtja e këtij kuvendi të LDK-së ka ardhur pas zgjedhjeve të 14 shkurtit, ku kjo parti regjistroi rezultat të dobët, duke fituar 12.73 për qind të votave, gjë që çoi në paralajmërimin e Isa Mustafës për tërheqjen nga udhëheqja e partisë. Pas fillimit të punimeve në Kuvendin e LDK-së, ish-kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka dhënë edhe zyrtarisht dorëheqje nga detyra e kryetarit të kësaj partie. Në një prononcim për media, ai ka deklaruar se dorëheqja e tij ishte e përvokueshme dhe për këtë shkak nuk është hapur fare diskutim në këtë kuvend lidhur me dorëheqjen e tij. "Kam besim edhe sot që ky kuvend do të nxjerrë një kryetar të LDK-së, i cili do ta çojë atë përpara, mbi bazat fundamentale mbi të cilat është themeluar kjo parti, si parti e qendrës së djathtë, parti konservatore, parti e të gjitha generatave. Ajo kultivon partneritetet të fuqishëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partneritet me Bashkimin Evropian. Është parti që është cilësuar gjithmonë shtetformuese, e cila në asnjë rast nuk duhet t'i mungojë skenës politike të Kosovës. Por, besoj fuqishëm se do të kthehet në të ardhmen në krye të vendit", ka thënë Mustafa.

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 MARS - Kuvendi i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka zgjedhur të dielën Lumir Abdixhikun kryetar të ri të kësaj partie. Ai ka marrë 191 vota të 328 delegatëve të këtij kuvendi. Në këtë garë me vota të fshehta, Abdixhiku ka mposhtur nënkryetarin e LDK-së, Lutfi Haziri, i cili ka marrë 116 vota dhe anëtarin e kryesisë të kësaj partie, Besian Mustafa, i cili ka marrë vetëm 16 vota. Ndërsa kryetari i Degës së LDK-së në Prizren, Anton Quni, ka hequr dorë nga kandidatura e tij për kryetar pak para fillimit të

Kuvendit Zgjedhor.

Pas marrjes së detyrës së udhëheqësit të LDK-së, Abdixhiku ka thënë se kjo parti do ta nisë rrugën për t'u kthyer aty ku e ka vendin. "Sot po e hapim një faqe të re të rrugëtimit tonë, me synime të qarta për ta kthyer LDK-në në vendin që i përket. Përgjatë viteve, LDK-ja mbrojti vendin si pozitë ashtu edhe opozitë. LDK-ja u tregua promotore e këtyre vlerave. Nga vetvetja duhet ta nisim rikthimin tonë të madh. Sot dhe nesër, ne nderojmë secilin, çdo udhëheqës të LDK-së. LDK-ja nderon udhëheqësinë paraprake. Kjo shtëpi duhet ta gjejë forcën për

Profili i kryetarit të ri të LDK-së

Kryetari i ri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka lindur më 22 prill 1983. Ka përfunduar studimet universitare në Universitetin e Prishtinës, kurse gradën master i Shkencave në Ekonomi e mori në vitin 2006 në Universitetin Staffordshire në Britani. Në vitin 2013, po në këtë universitet, doktoroi në ekonomi, pas katër vjet kërkimesh dhe hulumtimesh në fushën e përcaktuesve të evazionit të taksave të biznesit në vendet në tranzicion. Abdixhiku është drejtor ekzekutiv i Institutit "Riinvest". Ai u bashkua me Institutin në vitin 2005 dhe që atëherë ka qenë i përfshirë në disa projekte kërkimore, avokuese dhe zhvillimore në Kosovë dhe jashtë saj. Ai ka aderuar në LDK në maj të vitit 2017. Në zgjedhjet e këtij viti ai bëhet deputet për herë të parë



dhe më pas kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës. Në zgjedhjet e vitit 2019, Abdixhiku ishte politikani i nëntë më i votuar në Kosovë dhe filloi mandatin e dytë si deputet i Kuvendit të Kosovës. Pas këtyre zgjedhjeve, ai ishte ministër i Infrastrukturës dhe Mjedisit në qeverinë Kurti. Në zgjedhjet e 14 shkurtit ishte kandidati i tretë më i votuar në LDK, me 25 267 vota.

Vlerësohet mbarëvajtja e Kuvendit Zgjedhor të LDK-së

Mbarëvajtja e Kuvendit Zgjedhor të LDK-së është vlerësuar lart nga njohësit e rrethanave politike. Ata kanë thënë se partitë e tjera politike duhet të marrin shembull nga ky rast. "Nga kuvendi i karrigeve në një kuvend që duhet të merret shembull nga të gjitha partitë politike. Ky është një avancim drejt një skene politike për t'u marrë shembull. Urime kryetarit Lumir Abdixhiku, po ashtu kandidatëve të tjerë të cilët treguan leadership duke pranuar humbjen me nder", ka shkruar në profilin e vet në "Facebook" analisti Ilir Ibrahimimi.

Edhe gazetari Adriatik Kelmendi ka vlerësuar atmosferën në të cilën LDK-ja



ka mbajtur kuvendin zgjedhor. "Sot partia më e vjetër në vend, LDK-ja, e votoi për kryetar një 38-vjeçar, i cili vetëm katër vjet më parë iu bashkua. Kuvendi shkoi në

atmosferë feste, të gjithë kundërkandidatët e uruan fituesin dhe premtuan bashkëpunim", ka shkruar Kelmendi në profilin e vet në "Facebook".

Pacoli uron Abdixhikun: E ardhmja e Kosovës është brezi i ri

Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka uruar Lumir Abdixhikun për zgjedhjen në krye të LDK-së. Me këtë rast, Pacolli ka thënë se e

ardhmja e Kosovës është brezi i ri. "Me një besim të fortë se LDK-ja do të kthehet e fortë, unë do të doja ta përgëzoja udhëheqësin e ri të sapozgjedhur të partisë,

politikanin e ri e të besueshëm, Lumir Abdixhiku. E ardhmja e Kosovës është brezi i ri!", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

KQZ-ja certifikon rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit



PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar të shtunën rezultatin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, ku Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit ka shënuar fitore bindëse. Nga certifikimi i këtyre

rezultateve, Lëvizja Vetëvendosje ka 50,28 për qind apo 438 mijë e 335 vota, PDK-ja 148 285 vota apo 17 për qind, LDK-ja ka 110 985 vota apo 12,73 për qind, AAK-ja 62,111 vota ose 7.124 për qind.

Kjo do të jetë legjislatura e tetë e Kuvendit të Kosovës dhe në bazë

të rezultatit, Lëvizja Vetëvendosje do të ketë 58 ulëse, Partia Demokratike e Kosovës 19 ulëse, Lidhja Demokratike e Kosovës 15 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës tetë ulëse.

Pas certifikimit të rezultatit, sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti i Kosovës, në këtë rast

ushtruesja e detyrës e presidentit, Vjosa Osmani, brenda 30 ditësh duhet ta thërrasë seancën e parë të Kuvendit, në mënyrë që të formohen institucionet e dala nga zgjedhjet.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, pas certifikimit të zgjedhjeve ka bërë thirrje që deputetët e rinj ta

bëjnë reformën zgjedhore. "Dua t'u drejtohem deputetëve të legjislaturës së ardhshme, subjekteve politike, që reformën zgjedhore të mos e lënë në udhëkryq, por t'ia japin rrugën e duhur. KQZ-ja është e gatshme ta japë kontributin e vet profesional në këtë reformë", ka thënë Daka.

Një muaj paraburgim për kryetarin e Kllokotit

KLLOKOT, 14 MARS (ER) - Gjykata Themelore në Prishtinë i ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji kryetarit të Komunës së Kllokotit, Bozhidar Dejanoviq.

Dejanoviq u arrestua të premten, më 12 mars, nën dyshimin se ka kryer veprën penale "cenim i përcaktimit të lirë të votuesve". "Ekziston dyshimi i bazuar se i

pandehuri B. D., në cilësinë e kryetarit të Komunës së Kllokotit, ka kanosur seriozisht punëtorët e Komunës të Kllokotit dhe qytetarët e kësaj komune, duke ndikuar në

vullnetin e tyre që të votojnë në mënyrë të caktuar, për një subjekt të caktuar politik dhe për kandidatë të caktuar", thuhet në njoftimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës.



Dejanoviqi është anëtar i subjektit politik Lista Serbe.



Pacolli fton deputetët të hapin rrugë për formimin e qeverisë së re

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, është i vetmi nga kjo parti që ka fituar ulëse në legjislaturën e re të Kuvendit të Kosovës, ku në zgjedhjet e 14 shkurtit ishte pjesë e listës së LDK-së. "Pas certifikimit të zgjedhjeve falënderoj të gjithë votuesit e AKR-së, të cilët edhe këtë herë më

dhanë mundësinë të jam zëri i tyre në Kuvend. Është nder dhe përgjegjësi për mua. Kuvendi i Kosovës ta fillojë punën sa më parë. I ftoj kolegët e mi deputetë ta respektojnë vullnetin e sovranit dhe të hapin rrugë për formimin e qeverisë së re", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" lideri i AKR-së, Behgjet Pacolli.

Përkujtohen viktimat e masakrës të tregut në Mitrovicë

MITROVICË, 14 MARS (ER) - Qendrën e qytetit të Mitrovicës para 22 vjetësh forcat serbe e sulmuan me minahedhës derisa tregu ishte përplot me njerëz. Si pasojë e hedhjes së granatës, në treg mbetën të vdekur gjashtë persona, në mesin e të cilëve kishte fëmijë dhe gra, ndërsa lëndime të rënda dhe të lehta morën 128 shqiptarë. Me këtë rast, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka, përfaqësues të institucioneve

dhe asociacioneve të tjera, familjarë të viktimave dhe të plagosurve, janë mbledhur për t'i përkujtuar viktimat e masakrës së tregut në Mitrovicë që ka ndodhur 22 vjet më parë.

Kryetari Bahtiri para të pranishmëve tha se këta njerëz, por edhe të gjithë të tjerët që dhanë jetën për Kosovën, meritojnë përvulje dhe respekt të përjetshëm, duke kërkuar nga autoritetet që të veprojnë dhe autorët e kësaj masakre të dalin para

drejtësisë. "Këta njerëz, por edhe shumë të tjerë që kanë dhënë jetën për këtë vend pa fajin e tyre, nga një agresor shekullor, i cili dëshiron të mbetet agresor, dhe ende dëshiron që të ketë dorë në Kosovë, ne ju themi stop atyre, dhe kërkojmë nga institucionet më të larta shtetërore dhe ato botërore, që këta njerëz të cilët kanë shkaktuar këto viktima, të përgjigjen para drejtësisë. Kjo është kërkesa jonë legjitime dhe njerëzore", ka thënë kryetari Bahtiri.



Gjashtë të vdekur dhe 565 raste të reja me Covid në Kosovë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR, si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 3 444 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 565 raste

pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar gjashtë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prizren dy raste (64, 64 vjeç), Dragash një rast (86 vjeç), Prishtinë një rast (72 vjeç), Suharekë një rast (78 vjeç) dhe Vushtrri një rast (67 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 77 253 raste nga 354 967 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 702 raste të të vdekurve.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 304 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 64 666 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 10 885. Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 231 raste, Pejë 44 raste, Ferizaj 35 raste, Gjakovë 32 raste, Mitrovicë 31 raste, Gjilan 22 raste, Fushë-Kosovë 21 raste, Vushtrri 20 raste, Kamenicë 18 raste, Obiliq 15 raste, Podujevë 12 raste, Viti 10 raste, Prizren 9 raste, Drenas 8 raste, Lipjan 8 raste, Skenderaj 8 raste, Suharekë 8 raste, Deçan 6 raste, Rahovec 5 raste, Graçanicë 4 raste, Novobërdë 4 raste, Istog 3 raste, Klinë 3 raste, Dragash 2 raste, Kaçanik 2 raste, Kllokot 2 raste dhe me nga një rast komunat Hani i Elezit dhe Shtërpçë.

Kosova pa asnjë gazetë të shtypur

PRISHTINË, 14 MARS - Në Kosovë gazetat e shtypura janë zhdukur. Sot Kosova është i vetmi vend në rajon dhe Evropë pa gazetë të tillë, revistë javore apo mujore, kanë thënë Imer Mushkolaj, drejtor ekzekutiv në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës dhe profesori i gazetarisë, Milazim Krasniqi. Zhvillimi i teknologjisë, e veçmas përdorimi i internetit në masë të madhe, politizimi i gazetave, vështirësitë financiare të kompanive mediale dhe, së fundmi, pandemia e shkaktuar nga koronavirusi, sipas tyre, janë faktorët që kanë ndikuar në shuarjen e mediave tradicionale.

Mushkolaj: Pandemia i dha goditjen përfundimtare botimit të gazetave

Deri para një viti në Kosovë, tregon Mushkolaj, janë botuar katër gazeta ditore: "Koha Ditore", "Epoka e re", "Zëri" dhe "Bota sot". Por, në muajin mars të vitit të kaluar këto ndërprehen botimin, pas vendosjes së masave kufizuese nga qeveria e atëhershme, për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe futjen e vendit në izolim, e këto media vazhduan punën online.

Çështja e financimit mbetet një tjetër problem, ka thënë Mushkolaj, duke e konsideruar të vështirë rikthimin e botimit të tyre. "Pandemia i dha një goditje përfundimtare botimit të gazetave për shkak se kostoja e botimit të gazetave në njërin anë dhe anën tjetër tirazhet jo të mëdha të këtyre gazetave, shuma e vogël e mjeteve financiare të gjeneruar nga shitja, janë arsyt kryesore që një gjë e tillë ndodhi. Pas përfundimit të pandemisë do të jetë e vështirë që këto gazeta të mund të rifillojnë të dalin në treg për shkak se pa një ndihmë financiare, që do të duhej të vinte nga institucionet, është e pamundur të botohen", ka thënë Mushkolaj për "Radion Evropa e Lirë".

Një nga gazetat që kishte qëndruar në treg për 20 vjet ishte e përditshmja "Zëri". Kjo gazetë kishte filluar të shtypet në vitin 2000, me një tirazh mbi 7 500 kopje në ditë, kurse botimin e ka ndërprerë më 14 mars të vitit të kaluar dhe funksionon në formën online, ka thënë drejtori financiar i

këtij mediu, Ismail Musliu. "Kostoja e shtypit është e lartë, fuqia blerëse dhe publikimi i reklamave kishte rëndë dukshëm. Shtypjen e gazetave, pa e mirëmbajtur dikush, nuk mund vetë të ekzistojë", ka thënë Musliu.

Gazetat në "xhep"

Qytetarë të moshave të ndryshme në Kosovë japin mendime të ndryshme sa i përket rëndësisë së ekzistencës të gazetave të shtypura në treg. Afrim Shala ka punuar ekonomist në një nga ndërmarrjet publike. Ai ka thënë se çdo mëngjes ka blerë një nga gazetat e botuara dhe tashmë i mungojnë shumë. "Unë i kam lexuar gazetat, duke filluar nga 'Rilindja', 'Bujku', pastaj gazetat e tjera ditore që kanë qenë pas luftës. Mua më mungojnë shumë sepse të lexuarit e gazetës është më mirë edhe për shëndet, edhe për çështje të tjera. Edhe të kuptuarit është më i lehtë, ndryshe nga interneti. Në fletë e përjeton ndryshe rrëfimin apo ngjarjen", ka thënë Shala. Artan Duriqi, shitës në një nga kioskat në qendër të kryeqytetit, tregon se nga muaji mars i vitit të kaluar asnjë gazetë ditore më nuk del në treg. Ai tregon se ka raste kur kërkohen, në të shumtën e rasteve, nga moshat e vjetra. "Para pandemisë janë shitur, jo shumë, por ka pasur kërkesa", ka thënë Duriqi. Por, një qytetar tjetër, i cili blinte gjëra në kioskë, i pyetur a i mungojnë gazetat, është shprehur se të "gjitha gazetat i ka në xhep", duke aluduar në telefonin e mençur.

Zhdukja gazetave të shtypura nga tregu nuk duket interesante për Arbër Beqirin, 18 vjeç. Ai ka thënë se internetin e përdor si burim i informacionit. "Përdor teknologjinë e avancuar për të marr informacione, pasi është më lehtë dhe më shpejt. Gazeta e kam parë gjyshin duke lexuar, por tashmë as ai nuk i lexon", ka thënë ai.

Përdorimi i internetit sfidon gazetat e shtypura

Zhvillimi i teknologjisë, ka thënë Mushkolaj, sidomos përdorimi i internetit në masë të madhe nga qytetarët, për shkak të shpejtësisë të përhapjes së lajmit si dhe koston më të vogël në shpërndarjen e lajmit, ka



ndikuar që kompanitë mediale të ofrojnë shërbime vetëm online. "Duhet të merret parasysh se Kosova është shumë mirë e mbuluar me internet dhe qytetarët e Kosovës janë përdorues të mëdhenj të telefonave mobilë dhe të pajisjeve të tjera, ku qasja në këto përmbajtje online është jashtëzakonisht e lehtë. Kjo është një ndër faktorët kyçë, por mos të harrojmë se jo të gjithë qytetarët e Kosovës dinë apo duan të kenë qasje në përmbajtje online. Kështu që, është e domosdoshme dhe e nevojshme që të ketë edhe një media të shkruar", është shprehur ai. Përdorimi i internetit vitet e fundit ka pasur rritje të madhe në Kosovë. Sipas të dhënave zyrtare, 93 për qind e kosovarëve kanë qasje në internet. Kurse numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit mobil apo qasja në internet përmes rrjetit mobil 3G dhe 4G ka arritur në 1,3 milion përdorues.

Krasniqi: Shuarja e gazetave, disfatë kulturore

Disfatë kulturore, politike dhe biznesore për gjithë shoqërinë e konsideron shuarjen e gazetave ditore, Milazim Krasniqi, profesor i gazetarisë në Universitetin e Prishtinës. Ai është shprehur se politizimi i gazetave të shtypura dhe mungesa e një vullneti politik për ta mbajtur në jetë shtypin ditore, janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar në shuarjen e tyre. "Afërsia e pronarëve të gazetave me partitë politike ka dëmtuar reputacionin e

mediave të shkruara. Kjo tashmë është konsumuar dhe paraqiti krizën në të cilën jemi. Këto të dyja së bashku kanë sjellë krizën. Përndryshe, teknologjia informative, siç ka mundur të jetë e metë, mund të jetë edhe favor sepse zhvillimi teknologjik, ka mundur dhe mund ta ulë koston e përgatitjes të gazetave, ta rritë efikasitetin dhe imazhin e tyre në sytë e publikut që të identifikohen me atë media. Kjo ndodh në gjithë botën dhe as që bëhet fjalë për shuarje të gazetave", ka thënë ai.

Rikthimi i "Rilindjes"

Profesor Krasniqi ka vlerësuar se institucionet e Kosovës duhet të krijojnë politika për ta mbrojtur tregun e gazetave të botuara. Madje, sipas tij, Kuvendi i Kosovës duhet të krijojë bazë ligjore që të rikthehet në treg gazeta e parë në Kosovë, "Rilindja", fillimisht si gazetë publike. Kosova, thotë Krasniqi, duhet t'i ketë së paku tri gazeta ditore në treg. "Diçka duhet të bëhet sepse mbyllja e të gjitha gazetave nuk ka rezultuar me asnjë deklaratë as nga zyrtarët e Kuvendit, as të qeverisë dhe as të partive politike. Pra, është një injorancë kolektive e kësaj elite politike dhe kjo tregon edhe shkakun kryesor të mbylljes të gazetave ditore sikundër tregon edhe heshtja e pronarëve të medieve një konsumim të tyre në tregun medial", ka thënë Krasniqi. Gazeta e parë shqipe në Kosovë ishte "Rilindja", që fillimisht ishte gazetë e përjavshme. Kurse nga viti 1958 kjo gazetë ishte e përditshme. Tirazhi maksimal i

saj ka arritur mbi 200 mijë ekzemplarë për një ditë. Në vitin 1990 botimi i saj u ndalua nga pushteti i atëhershëm serb, për të rinisur përsëri në vitin 1999, pas hyrjes të forcave të NATO-s në Kosovë. Gazeta "Rilindja" u mbyll në vitin 2002, pas largimit nga Pallati i Rilindjes. Edhe Mushkolaj ka pohuar se në tregun e Kosovës duhet të ekzistojë shtypi ditore, qoftë edhe në mënyrën publiko-private.

"Për fat të keq, Kosova ka kohë që e ka mbyllur gazetën e parë të botuar, 'Rilindjen', dhe kjo ka kaluar në heshtje. Ndryshe nga vendet e rajonit, ku 90 për qind e mediave që kanë ekzistuar në kohën e 'Rilindjes' vazhdojnë të funksionojnë, kjo tregon se çfarë qasje kemi ne si shoqëri ndaj gazetarisë. Duhet të gjendet një gazetë publiko-private, që të mund të funksionojë në treg edhe për shkak të një lloji trashëgimie kolektive historike dhe kulturës që ekziston në çdo vend të botës", ka thënë Mushkolaj.

Në vitin 2009, vetëm një vit pas shpalljes së pavarësisë, në Kosovë janë botuar tetë gazeta ditore, të gjitha në gjuhën shqipe. Në një hulumtim të Institutit të Kosovës për Hulumtime dhe Zhvillim Politikash (KIPRED), realizuar në vitin 2010, thuhet se tetë gazetat ditore ("Koha ditore", "Kosova sot", "Express", "Epoka e re", "Bota sot", "InfoPress", "Zëri" dhe "Lajm"), kanë pasur tirazh mes 25 000 dhe 35 000 kopje. Ky numër në atë kohë ishte vlerësuar tejet i ulët në krahasim me popullsinë e përgjithshme (2.1 milion banorë). Në atë kohë, tre në pesë njerëz lexonin një gazetë ditore.



Skënder Thaçi: Qeveria e ardhshme ta kthejë vëmendjen kah turizmi malor

Nënkryetari i Odës i Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, Skënder Thaçi, njëherësh pronar i hotelit “Magra Austria” në Bogë, ka thënë se për shkak të veprimeve qeveritare janë dëmtuar shumë gjatë kohës së pandemisë Covid-19. Ai ka thënë se me mbylljen pishinave dhe lokaleve në Kosovë qytetarët udhëtuan në vendet turistike në rajon. Thaçi ka thënë se qeveria e ardhshme duhet ta ketë prioritet zhvillimin e turizmit malor

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 14 MARS - Nënkryetari i Odës i Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, Skënder Thaçi, ka thënë se qeveria e ardhshme duhet ta ketë prioritet turizmin malor. Ai ka theksuar se që njëzet vjet pas çlirimit, qeveritë e Kosovës turizmin malor nuk e kishin prioritet. “Shpresoj se qeveria e ardhshme do ta ketë prioritet turizmin malor, pasi kemi shumë vende turistike si Bjeshkët e Rugovës, Brezovica, Sharri e të tjera që janë atraksione turistike dhe kanë potencial të zhvillimit. Në këtë drejtim duhet të ketë

politika qeveritare që ndihmojnë këtë sektor”, ka thënë Thaçi për gazetën “Epoka e re”. Sipas tij, sektori i bujqësisë dhe turizmit janë dy sektorët që mund të ndikojnë në rritjen ekonomike dhe në punësim. “Qeveria në vazhdimësi ka mbështetur sektorin e bujqësisë me grante dhe subvencione, mirëpo një gjë e tillë s’ka ndodhur për turizmin malor. Si protagonist i kësaj fushe mund t’ju them se ndihemi të diskriminuar”, ka thënë ai. Nënkryetari i Odës i Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës ka theksuar se qeveria e ardhshme duhet të ketë strategji të qartë turistike në mënyrë që qytetarët të

orientohen kah turizmi malor vendor. “Qeveria që lamë pas ka bërë gabime të mëdha, sepse mbylli pishinat, mbylli restorantet dhe qytetarët e Kosovës udhëtuan drejt vendeve të rajonit si në Shqipëri dhe në Maqedoni të Veriut, duke i shpenzuar kështu paratë e tyre në këto vende dhe duke e dëmtuar dhe më shumë turizmin vendor. Mos të harrojmë se Rugova ka bukuri të shumta, gjithashtu ka ajrin e pastër. Ka të gjithë parametrat që i nevojiten turizmit, mirëpo duhet vetëm të mos ndëshkohemi me masa diskriminuese nga Qeveria e Kosovës. Shpresojmë se qeveria e ardhshme nuk do ta

bëjë këtë gabim dhe nuk do të na dëmtojë edhe më shumë”, është shprehur ai.

Thaçi ka folur edhe për sfidat me të cilat janë përballur gjatë kohës së pandemisë. “Me mbylljen e restoranteve neve na është dashur që të gjithë mallin që kishim në stok për kuzhinë ta gjuajmë dhe një pjesë ta falim. Kjo na ka kushtuar materialisht. Po ashtu, punëtorët të cilët pushuan në atë kohë është dashur t’i paguajmë dhe më t’u kthyer më pas në punë s’kishim numër të klientëve për t’u shërbyer. E tërë kjo ka rënduar ambientin e të bërit biznes dhe turizmin malor”, ka deklaruar Thaçi.

Sa i përket ndihmës financiare me anë të pakove për rimëkëmbjen ekonomike, Thaçi ka thënë se kjo ndihmë nuk ka qenë e mjaftueshme. “Ndihma e dhënë nga Qeveria e Kosovës nuk ka qenë e mjaftueshme. Shtu këto faktin edhe për shkak të mbylljes që kishim për një kohë dhe ikjes së turistëve në vendet e rajonit si në Shqipëri dhe Maqedoni”, ka deklaruar ai. Thaçi ka thënë se infektimi me Covid-19 nuk vjen nga restorantet dhe turizmi malor, por nga shkollat dhe institucionet. “Unë isha në ndërtesën e re të Qeverisë së Kosovës dhe aty para ashensorit prisnin pesëmbëdhjetë persona, pra një grumbull njerëzish qëndronin duke mos respektuar masat kundër Covidit. Kurse neve afaristëve na kufizojnë. Ju e dini si kanë vepruar në fushatë dhe çfarë grumbulli njerëzish kishte në ambiente të mbyllura”, ka bërë me dije Thaçi.

Ndërkaq sa i përket mundësisë së mbylljes si pasojë e rritjes së numrit të rasteve me Covid ditët e fundit, Thaçi ka thënë se mbyllja e sërishme do të ishte fatale për bizneset në Kosovë. “Ne assesi nuk jemi kundër masave të vëna nga Qeveria e Kosovës dhe e kemi respektuar çdo masë duke filluar nga distanca, mbajtja e dizenfektuesve dhe numri i limituar. Në ‘Magra Austira’ çdo masë është respektuar. Mirëpo që të mbyllet edhe një herë bizneset, mendoj se ky veprim duhet të anashkalohet nga Qeveria e Kosovës. Turizmi malor duhet të jetë në agjendë të qeverisë së re. Ne respektojmë çdo masë, mirëpo assesi ta mbyllim veprimtarinë tonë dhe t’i mbyllim dyert për turistët. Një pjesë e madhe e popullatës e ka kaluar Covidin. Ne jemi njëmbëdhjetë anëtarë të familjes dhe dhjetë prej nesh e kanë kaluar Covidin, prandaj them se duhet vetëm kujdes dhe kursesi mbyllje”, ka deklaruar Thaçi.

Ministri Nitaj rikthen në procedurë të rregullt tenderin për eficiencën e energjisë

PRISHTINË, 13 MARS (ER) - Ministri në detyrë i Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Muharrem Nitaj, ka kërkuar që tenderi i shpallur nga Agjencia për Eficiencë të Energjisë, për ndriçim publik në 23 komuna, të zhvillohet sipas procedurave të rregullta. Ministri Nitaj ka kërkuar që kjo procedurë të mos shkojë me procedurë të përsheptuar, pasi nuk ka arsye për një veprim të tillë. “Agjencia për Eficiencë të Energjisë ka hapur tender për zbatimin e masave të eficiencës të energjisë për ndriçimin publik në 23 komuna dhe kjo me procedurë

të përsheptuar. Megjithëse në arsyetimin e njësisë kërkuese thuhet se ‘hapja e tenderit është bërë me afat të shkurtuar të dorëzimit të ofertave, meqenëse projekti në fjalë do të jetë bashkëfinansim me komuna dhe jemi përballë pandemisë Covid-19, e ku buxheti i donatorëve të komunave do të duhet të kryhet brenda vitit fiskal’, unë si ministër nuk shoh asnjë arsye të vlefshme që tenderi të hapet me afate të përsheptuara, prandaj kam kërkuar edhe zyrtarisht që ky proces të zhvillohet sipas procedurave të rregullta”, ka thënë Nitaj.



Bitcoin po thyen të gjitha rekordet, tani vlen mbi 60 000 dollarë



PRISHTINË, 14 MARS - Vlera e Bitcoinit ka tejkaluar shumë e 60 mijë dollarëve, duke tejkaluar kështu vlerën rekord të kësaj kriptovalute. Vlera e Bitcoinit në platformën Binance ka “kërcyer” në 5,77 për qind, duke arritur çmimin prej

60.104 dollarësh. Nga fillimi i vitit, Bitcoin është forcuar dukshëm për 80 për qind, kurse në 12 muajt e fundit vlera e tij është rritur për 570 për qind. E rritjes i kanë prirë një mori faktorësh, përfshirë rritjen e interesimit të investitorëve

të mëdhenj, si dhe investimi i korporatave sikurse janë Tesla, Square dhe Microstrategy. Bitcoin është një kriptovalutë që e ka shpikur një person i panjohur apo një grup njerëzish gjatë vitit 2008, duke përdorur emrin Satoshi

Nakamoto. Bëhet fjalë për valutë digjitale të decentralizuar pa bankë qendrore apo president, që mund të dërgohet nga përdoruesi në përdoruesin tjetër në mënyrë direkte, pa nënkryetar, përmes rrjetit të Bitcoinit.

Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (6)

A kishte dijeni Enver Hoxha se viti 1981 do të ishte njëkohësisht edhe viti i kryengritjes shqiptare?



Shkruan: Bedri ISLAMI

Ndodhi që po ato ditë, me ftesë të një klubi shqiptar, erdhi në Shtutgart një ambasador i rëndësishëm i Shqipërisë në vendet perëndimore. Ishim miq të vjetër. Kishim biseduar gjatë me njëri-tjetrin. Në një rën nga ditët e qëndrimit të tij, ndërsa rrinim në banesën time, i thashë se tashmë bisedat tona do të ishin më të rralla, meqë e kisha ndarë mendjen prej disa kohëve të isha pjesë e Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe bisedat tona telefonike mund të përgjoheshin. Ai, pasi më tha se duhet të bëja kujdes se gjithçka mund të më ndodhë, më tregoi se do të kishte një zmbarsje në qëndrimin ndaj

Kosovës.

- Ndaj, - shtoi lehtas - mos prit që miqtë e dikurshëm të të kuptojnë. Gjërat kanë ndryshuar, - më tha dhe biseda vijoi me gjërat e zakonshme.

Nuk është koha të analizoj se çfarë ndodhi në katër vite, që solli një regres kombëtar kështu të dhimbshëm. Shembujt i solla për të pasur një lidhje mes asaj që quhet e zakonshme, e nganjëherë e rëndomtë, kur analizojmë ngjarjet e marsit 1981 e ndalemi tek qëndrimi i qytetarëve të thjeshtë dhe mendimit politik zyrtar.

Për këdo, natyrisht, lajm përbën dilema e shtruar atëherë, nëse kishte dijeni Shqipëria zyrtare për atë që po përgatitej të ndodhte në Kosovë. A kishte dijeni Enver Hoxha, prej strukturave të tij, se viti 1981 do të ishte njëkohësisht edhe viti i kryengritjes shqiptare? A ndikuan strukturat e fshehta të shtetit shqiptar në organizimin, apo të paktën

nxitjen e kryengritjes dhe afishimin e parullës "Kosova-Republikë", apo të thirrjes "Republikë, Kushtetutë - ja me hatër - ja me luftë"? A kanë qenë të përgatitura dhe të instraktuara organizatat ilegale që u vunë në ballë të demonstratave nga strukturat e fshehta të shtetit shqiptar? A kishte në Tiranën zyrtare përkrahjen e duhur kërkesa për republikën e Kosovës apo shteti shqiptar ishte vetëm pro krijimit të një shteti të dytë shqiptar në Ballkan? Përkrahja e shtetit shqiptar ishte e vonuar apo u ndërmor në kohën e duhur? E gjithë ajo që ndodhi në polemikën e madhe mes shtetit shqiptar dhe shtetit jugosllav ishte thjeshtë një retorikë ideologjike apo pas saj fshihej edhe çështja kombëtare?

Unë do përpiqem të sjell disa nga përjetimet e dyzet viteve më parë, ashtu si i kam përjetuar unë, qoftë si qytetar i zakonshëm, qoftë si gazetar. E di se për disa do të jetë disi e

pazakontë, ndoshta edhe jashtë rrjedhës së trysnisë politike që përçohet ndaj shtetit shqiptar të atyre viteve, mirëpo unë do bëj mundim të sjellë atmosferën ashtu si ishte në ato ditë, ashtu si është përjetuar nga unë dhe njerëzit rreth meje, nga shokët e mi gazetarë, por edhe nga njerëzit e shquar të artit, shkencës e historisë. Do ia lejoj vetes, që ashtu si i kam ndjekur dhe ashtu si i kam analizuar më pas, të sjell edhe pikëpamjen time për ato që ishin asokohe në mendimin politik zyrtar, duke shfrytëzuar të drejtën nga takimet e mëpasshme që kam pasur me disa nga protagonistët e këtyre ngjarjeve në Shqipëri, mes të cilëve edhe me ish presidentin e Shqipërisë, Ramiz Alia. Të gjitha këto nuk i sjell për të nxitur një mendim 'ndryshe' ose një mendim 'për', por për të përcjellë disi ato të vërteta që ose janë thënë ndryshe, ose janë thënë të cinguar.

Le të nisim me atë që përjetuan

njerëzit e zakonshëm...

Në mesin e muajit mars të vitit 1981, ata që punonin një kat më poshtë në redaksinë e gazetës "Zëri i Popullit" vunë re se në sektorin e jashtëm, i cili ishte në katin e sipërm, kishte një lëvizje më të madhe se e zakonshme, një lëvizje përgjithësisht më të ndjeshme se herët e tjera. Kjo ndodhte kur ishte rasti i ngjarjeve të rëndësishme. Por këtë herë, shumë më shpesh se më parë, kishin filluar të vinin funksionarë të rëndësishëm të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, të cilët, jo rrallëherë, nuk ndaleshin as në zyrën e kryeredaktorit të gazetës, që ndodhej në katin e dytë. Megjithatë, nuk ishte vërejtur ende asgjë e jashtëzakonshme nëpër rreshtat e artikujve, të cilët, në më të shumtën e rasteve, nuk kishin ndonjë gjë të veçantë. Edhe fakti që përgjegjësi i sektorit të jashtëm ishte thirrur dy herë, brenda ditës, te shefi nuk përbënte lajm, pasi kjo kishte qenë





shpesh pjesë e rutinës. Zakonisht, nga ora nëntë e mëngjesit, 'djemtë e gazetës', si i thërrisnin miqtë e tyre të afërt, mes të cilëve edhe ish kryeministri i Shqipërisë, zoti Berisha, shkonin të pinin kafënë e mëngjesit, në kafenenë e Lidhjes së Gazetarëve, ku kishte më shumë zhurmë se në të gjitha kafenetë e tjera. "Zhurmëtarët" ishin nga hera Pëllumb Bato i "Bashkimit" (i cili nuk e di se ku ndodhet tani), Filip Çakulli i "Hostenit", i cili kishte mesatarisht një mosmarrëveshje në javë me shefin e tij a të kritikuarit prej tij, dhe shefi i sotëm i një gazete pro - PD Fahri Balliu, që asokohe ishte gazetar special i "Zërit të Popullit". Prej dy ditësh, ishte vënë re se gazetarët e sektorit të jashtëm të "Zërit të Popullit" e të "Bashkimit" ose nuk po vinin fare, ose pinin një kafe, të shpejtë dhe iknin. Ndërsa ata të sektorit të jashtëm të RTSH, që vinin nganjëherë për kortezi gazetareske, pasi kishin klubin e vet, nuk dukeshin. Përgjithësisht, për sektorët e jashtëm të shtypit, asokohe, punonin gazetarë nga më të mirët. Të aftë dhe patriotë, si u dëshmuar shumë

prej tyre në vitet në vijim. Tek "Zëri..." ishte i njohur Shaban Murati, tek "Bashkimi" ishte Napoleon Roshi, ndërsa tek RTSH, Bujar Muharremi. Megjithatë, fjalët kishin filluar të rridhnin, jo nga kanalet zyrtare, por nga 'rebelët' që ndiqnin herë pas here, kanalet radiofonike të huaja. Kishte filluar të flitej se në Prishtinë, dy a tri ditë më parë kishte pasur demonstrata, mirëpo nuk dihej më tepër. Njëri nga shokët e mi, që kishte qëndruar deri vonë për të ndjekur thujse të gjitha stacionet radiofonike që mund t'i kuptonte, më tregoi se në Prishtinë kishte pasur një demonstratë studentësh për kushte më të mira jetese dhe cilësi ushqimi dhe, si duket, nuk kishte pasur asgjë politike. Thënë të vërtetën, unë kisha disa kohë që isha përgatitur për një udhëtim në Kosovë, i cili, si më kishte thënë shefi im i atëhershëm Namik Dokle, do të zhvillohej në fund të muajit mars. E dija se në atë grup do të ishte edhe Vera Kapo, bija e 'numrit dy' të dikurshëm të PPSH-së, Hysni Kapos dhe nëna e gazetarit të sotëm, Andi Bushati. Pjesë e grupit do të ishte edhe Xhafer Dobrusha, pedagog në Universitetin e Tiranës, i cili ka drejtuar edhe

Federatën e Arsimit, e disa të tjerë. Kishte disa kohë që marrëdhëniet në dy anët e kufirit ishin intensifikuar dhe kishte arritur në një pikë të lartë. Kishte më shumë se pesë vite që mes dy qeverive, asaj në Beograd dhe asaj në Tiranë, kishte filluar një periudhë zbutje dhe, si duket, të dy palët kishin llogaritur të ndikonin tek njëra tjetra, përmes atyre elementëve që i konsideronin më të rëndësishëm. Qeveria e Beogradit mendonte të ndikonte në Shqipëri duke dërguar aty, përmes strukturave të ndryshme, një nivel më të ngritur jetese, njohje më të gjerë të botës, hapje më të ndjeshme; ndërsa qeveria e Tiranës kishte menduar të ndikonte përmes shkallës së kulturës, njohjes reciproke të artit, gjuhës e traditës, duke pasur gjithnjë në anën e saj përkushtimin e pakufishëm të shqiptarëve matanë kufirit për shtetin amë. Këtë masë përcaktuese, qeveria e Beogradit nuk e kishte llogaritur, ose e kishte përlllogaritur keq, ndërsa qeveria e Tiranës e kishte paraparë shkëlqyeshëm. Në Tiranë kishte filluar të rrezohej paragjykimi se "një shqiptar në

Jugosllavi është një titist" dhe nuk shihej si një kundërshtar ideologjik, megjithëse shteti shqiptar e dinte fort mirë se, në mesin e të ardhurve, jo pak ishin të tillë. Pranimi i gjuhës së përbashkët shqipe, ribotimi pa asnjë redaktim kritik i teksteve të historisë së Shqipërisë dhe pranimit të teksteve të njëllojta, thujse në të gjitha lëmenjtë; ansamblet artistike që ishin më të shpeshta se asnjëherë, këngët që ishin përgjithësisht mbi bazën e teksteve me ndjenjë të theksuar kombëtare, si ishte ajo e Pjetër Gacit "Kaçanik, o shkëmb e gurë...", pritja e jashtëzakonshme që i bëhej Nexhmije Pagarushës dhe ripërhapja e shpejtë e këngëve të saj ishin të gjitha më se të prekshme dhe të pranueshme nga njerëzit e zakonshëm. Kishte shumë kohë që në shtypin shqiptar, ku nuk mungonte edhe censura e kujdesshme, nuk shkruhej negativisht për Kosovën ose për njerëzit e saj. Termat që dolën më vonë, pas viteve '90-ta për Kosovën ose për shqiptarët e Kosovës, atëherë as njiheshin dhe as lejoheshin të përdroreshin. Edhe kur flitej për masakrën e 4 shkurtit

bëhej kujdes të evitohet emri i Xhafer Devës, sado që shumë gjëra ishin të ditura. Fakti që u vu re më pas është se, gjatë gjithë kohës që regjimi i Hoxhës ishte në pushtet, ishin ngritur veçse tre përmendore të mëdha për individë të shquar të periudhës së Pavarësisë dhe se që të tre kishin ardhur nga viset shqiptare të Kosovës: përkatësisht statujat madhore të Bajram Currit, Hasan Prishtinës dhe Isë Boletinit. Po ashtu, fakti që Enver Hoxha, në shënimin e tij për Monumentin e Pavarësisë, kishte kërkuar që, krahas Ismail Qemalit, të vihen në qendër të monumentit edhe figura e luftëtarit nga Kosova ishte e prekshme për njerëzit. Sado që të mos ishte dakord me regjimin, nuk mund të ishte kundër veprimeve të tilla, të cilat, edhe pse, ashtu si u tha më pas, mund të kishin të tjera nënshtresa, përsëri, në kohën e dhënë, ishin të mirëpritura. Qeveria shqiptare dhe mendja diabolike e Enver Hoxhës kishin ditur të luanin me historinë dhe tragjedinë. Aty ku hyn tragjedia, llahtaria mbetet gjithsesi.

(Vijon)





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Derbi nuk solli fitues, Ismet Munishi debuton me fitore

Nuk ka ndryshim në pozitat e para të renditjes tabelore në Superligën e futbollit. Ballkani dhe Drita ndan pikët, kurse Prishtina është mposhtur nga Feronikeli. Ismet Munishi ka debutuar me fitore si trajner i Gjilanit, pasi kjo skuadër e ka mposhtur Trepçën '89

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

Prishtinë, 14 mars - Derbi i javës së 25-të në Superligën e Kosovës në futboll në mes të Ballkanit dhe Dritës nuk solli fitues, pasi ndeshja përfundoi 0-0. Në pjesën e parë nuk pati ndonjë rast të mirë shënimi, kurse edhe pjesa e dytë ishte e baraspeshuar, pasi dy klubet patën nga një rast shënimi, por Xhevdet



Shabani dhe Meriton Korenica nuk i shfrytëzuan këto raste dhe ndeshja u mbyll 0-0. Duhet cekur se nga minuta e 81-të vendasit luajtën pa një lojtar, pasi nga loja u përjashtua Egzon Sinani.

Kampionia në fuqi, Drita, vazhdon të jetë e para në tabelë me 54 pikë, kurse në pozitën e dytë i njëjti futbollist realizoi golin e dytë, derisa mysafirët e ngushtuan rezultatin katër minuta para fundit me golin e realizuar nga Sadat Berisha, por kjo ishte e tëra që e arriti në këtë ndeshje. Gjilani renditet në pozitën e katërt me 36 pikë, kurse 89-shi është një pozitë më poshtë me 32 pikë. Dy klubet që

po luftojnë për mbijetesë, Drenica dhe Arbëria luajtën baras 1-1. Në minutën e 33-të, Englatin Gjoni e kaloi skuadrën kuqezë nga Skenderaj në epërsi, derisa mysafirët e barazuan rezultatin në minutën e 81-të, kur realizoi Çlirim Kashtanjeva. Drenica është e parafundit në renditjen tabelore me 26 pikë, kurse me një pikë më shumë renditet një pozitë më lart, Arbëria që drejtohet nga Arbnor Morina. Të shtunën skuadra e Feronikelit ka shënuar fitore në duel me Prishtinën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas me rezultat 2-0. Në këtë mënyrë "Nikli" e ndali serinë e prishtinasve prej 18 ndeshjeve pa humbje. Të dyja golat për skuadrën e drejtuar nga Klodian Duro i shënoi Marko Simonovski. Ndërsa në ndeshjen tjetër, Llapi shënoi fitore me rezultat bindës si mysafir ndaj Besës (4-1). Golat për llapjanët i shënuan Edon Sadriu, Engjëll Hoti, Valmir Veliu dhe Arbnor Ramadani, kurse golin e vetëm për pejanët e realizoi Ardit Tahiri.

SHKURT

Sejdini edhe një mandat në krye të Federatës së Futbollit të Maqedonisë

Muhamed Sejdini e ka fituar edhe një mandat në krye të Federatës së Futbollit të Maqedonisë. Të dielën Sejdini është konfirmuar në postin e presidentit edhe për katër vjet të tjera. Nga Kuvendi i Rregullt Zgjedhur i mbajtur në Shkup, Sejdini mori 52 vota për, ndërsa nuk kishte asnjë kundër. Muhamed Sejdini ishte kandidati i vetëm për postin e të parit në shtëpinë e futbollit maqedonas.

Liverpooli nxjerr në shitje Shaqirin dhe tre futbollistë të tjerë

Liverpooli në afatin kalimtar të verës do të jetë i hapur të negociojë me klubet e tjera për disa futbollistë si Xherdan Shaqiri, Matip, Origi dhe Chamberlain. Sipas mediave angleze, trajneri Jurgen Klopp nuk është i kënaqur me futbollistët në fjalë dhe ka vendosur që t'i vë në shitje. Xherdan Shaqiri, mesfushori kosovar që në "Anfield" erdhi në vitin 2018 me "Të Kuqtë", fitoi Ligën e Kampionëve, Premier Ligën, Superkupën e Evropës dhe Kupën e Botës për klube. Futbollisti nga Zhegra, sipas të gjitha gjasave, do të ndërrojë ambient në afatin kalimtar të verës, pas tre vjetëve të kaluara në "Anfield".

Reali është gati ta rikthejë Ronaldon

Në Spanjë po merr gjithmonë e më shumë kuota mundësia e rikthimit të Cristiano Ronaldos te Real Madridi. Është e përditshmja "AS" që i jep zë këtë skenari, duke zbuluar edhe një prapaskenë të bujshme. Sipas gazetës, Florentino Perez u pendua shpejt që e la CR7 të largohej dhe që në vitin 2019 provoi ta bindë portugezin të kthehej në Madrid. Por tani gjërat kanë ndryshuar. Ronaldo ka mbetur i zhgënjyer nga aventura juventine pas eliminimit të radhës nga Liga e Kampionëve dhe pritet të largohet në fund të këtij sezoni. Real Madrid kërkon ta shfrytëzojë këtë mundësi dhe duke qëndruar në atë që raporton "AS", Perez ka urdhëruar emisarët e klubit "Los Blancos" të nisin punën për transferuar sërish yllin portugez në La Liga.

SUPERLIGA - Java 25

Ballkani - Feronikeli	0-0
Drenica - Arbëria	1-1
Gjilani - Trepça '89	2-1
Feronikeli - Prishtina	2-0
Besa - Llapi	1-4

Tabela

1. Drita	25	54 pikë
2. Ballkani	25	52
3. Prishtina	25	50
4. Gjilani	25	25
5. Trepça '89	25	32
6. Feronikeli	25	31
7. Llapi	25	30
8. Arbëria	25	27
9. Drenica	25	26
10. Besa	25	7

Në xhiron e radhës takohen: Llapi-Arbëria, Drita-Drenica, Besa-Feronikeli, Prishtina-Gjilani, Trepça-Ballkani.

LIGA E PARË

Grupi A

Malisheva - Liria	1-0
Dukagjini - Vëllaznimi	2-1
A&N - Drenasi	0-0
Istogu - Trepça	3-0
Onix Banja - Vushtrria	0-1

Grupi B

Vitia - Ramiz Sadiku	2-3
Flamurtari - Kika	2-1
Ferizaj - KEK-u	0-1
2 Korriku - Vllaznia	2-1

Anulohet turneu i boksit 'Tërnoci 2021'

PRISHTINË, 14 MARS - Më 13 mars është anuluar turneu i boksit "Tërnoci 2021" që organizohet çdo vit nga Klubi i Boksit Tërnoci "Rida". Për këtë turne organizatori e kishte lejen nga të gjitha organet kompetente, por presioni kishte filluar disa ditë para turneut ndaj trajnerit të Klubit

të Boksit, Ridvan Imerit, që boksierëve nga Kosova nuk do t'u lejohet hyrja në territorin e Bujanocit. Trajtimi i keq ndaj shqiptarëve të Luginës ende ekziston. Nga ky rast ne pamë që iu mohua e drejta sportistëve pas përgatitjeve të shumta të cilat i kanë

bërë për të treguar sukses në këtë turne. Komuna e Bujanocit me udhëheqësi shqiptare nuk reagoi në asnjëfarë mënyre ndaj policëve serbë të cilët shkaktuan këtë kaos të madh ndaj sportistëve dhe organizatorit të turneut, profesor Ridvan Imerit.



Përfaqësuesja vazhdon përgatitjet, 'dardanet' të motivuara për ndeshjet në Austri

PRISHTINË, 14 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll (femrat) po vazhdon në Istog përgatitjet për ndeshjet e javës së ardhshme në Austri. Selektori Agron Shabani është i kënaqur me punën që po bëhet. Ai tregon se vajzat janë

shumë të motivuara. "Atmosfera është shumë e mirë. Ka kohë që nuk kemi pasur tubime të këtij lloji. Vajzat janë shumë të motivuara. Dita-ditës po kompletohem, pos Mirela Gjokaj që vjen direkt në Austri. Kushtet janë

fenomenale, ndërsa palestra vetëm për ne dhe shumë afër. Nuk ka si më mirë. Fati ynë i vetëm i keq që na mungojnë lojtare të rëndësishme", ka thënë Shabani. Në Austri Kosova do të luajë kundër Austrisë dhe Italisë në kualifikimet për Botëror.



Ponte Prizreni vazhdon me fitore. Rahoveci mposhti Pejën

Prizren, 14 mars - Ponte Prizreni ka vazhduar me fitore, duke mundur Vëllaznimin me shifrat 93:83 (24:13, 17:15, 29:24, 23:31), në kuadër të FIVE STAR Superligës së Kosovës në basketboll. Vendasit e filluan shumë mirë ndeshjen, duke fituar çerekun e parë 24:13. Lojë më e baraspeshuar u zhvillua në periudhën e dytë, që ishte 17:15, derisa skuadrat shkuan në pushim me shifrat 41:28. Prizrenasit thelluan edhe më shumë epërsinë në periodën e tretë, ku më e larta ishte 61:39, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 70:52. 10 minutat e fundit ishin formale, pasi fitorja e vendasve nuk u rrezikua, duke triumfuar në fund 93:83.

Te Ponte Prizreni u dalluan Divine Myles me 31 pikë e 6 kërcime, Kwame Vaughn me 27 pikë, 9 kërcime dhe 8 asistime dhe Josh Martin me 18 pikë e 16 kërcime, kurse te Vëllaznimi u dalluan Emmanuel Emogbo me 20 pikë, 8 kërcime dhe 8 asistime dhe Andi Shehu me 13 pikë e 10 kërcime. Ponte Prizreni është lider me 16 fitore dhe 7 humbje,



kurse Vëllaznimi është i fundit me 7 fitore dhe 16 humbje. Rahoveci ka shënuar fitore ndaj Pejës me shifrat 79:59 (12:7, 17:18, 27:19, 23:15), në kuadër të javës së 23-të në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll.

Në çerekun e parë u shënuan vetëm 19 pikë, ku kjo pjesë përfundoi 12:7 për vendasit. Pejanët e nisën më mirë periudhën e dytë, duke kaluar në epërsi 12:15, por Vreshtarët kundërpërgjigjen shpejt për 25:19. Më pas zhvillohet lojë e baraspeshuar, kurse pjesa e parë

përfundon 29:25. "Vreshtarët" e filluan më mirë pjesën e dytë, duke pasur epërsi deri në 13 pikë në periodën e tretë, që përfundoi me shifrat 56:64. 10 minutat e fundit ishin vetëm formalitet, pasi vendasit kontrolluan ndeshjen dhe fituan 79:59. Darell Davis i rikthyer te Rahoveci ishte më i dalluarit për vendasit me 30 pikë, 8 pikë e 7 asistime, kurse te Pjea më i dalluari ishte Brandon Walters me 22 pikë e 11 kërcime. Rahoveci ka 14 fitore dhe nëntë humbje, kurse 12 fitore dhe 11 humbje.

Nuk ndalet Brooklyn, fiton edhe Dallasi

DETROIT, 14 MARS - Fitorja e katërt radhazi për Brooklyn Netsin në NBA. Skuadra njujorkeze vazhdoi ecurinë pozitive duke mposhtur edhe Detroit Pistonsin me rezultatin 100-95. Më i miri mbi parket për Brooklynin ishte një nga tre fantastikët, pikërisht James Hardeni i cili shkëlqeu me një triple-double duke koleksionuar në total 24 pikë, 10 rebounde dhe 10 asistime. Për Nets kjo ishte fitorja e 26-të në 39 takime me Brooklynin që vazhdon të ushtrrojë presion ndaj Philadelphia's për vendin e parë në Lindje. Po kalon një moment të mirë në NBA edhe Dallas Mavericksi që mori fitoren e 7-të në 9 ndeshjet e fundit falë triumfit 116-103 ndaj Denver Nuggetsit brenda në Colorado. Denverit nuk i mjaftuan 26 pikë, 8 rebounde dhe 11 asistime nga Nikola Jokiq për ta evituar humbjen, ndërkohë që te Dallasi dy më të mirët rezultuan dy të përhershmit, Kristaps Porzingis dhe Luka Doniq, të cilët së bashku realizuan 46 pikë në total.



Po ecën me hapa gjigantë në konferencën e Lindjes edhe Atlanta Hawks që mori një tjetër fitore pasi mposhti pa shumë vështirësi Sacramento Kingsin me rezultatin 121-106. Trae Young me 28 pikë dhe 9 asistime ishte ai që udhëhoqi skuadrën nga Georgia drejt fitores së 4-t radhazi, ndërkohë që Sacramento, pavarësisht prej paraqitjes së shkëlqyer të Foxit, i cili realizoi 32 pikë, nuk arriti ta shmange humbjen numër 23 në këtë sezon.

Spikat edhe fitorja e Milwaukee Bucksit me rezultatin 125-119 në transfertën kryeqytetase ndaj Washington Wizardsit. Rusell Westbrook bëri një figurë të shkëlqyer në këtë ndeshje duke koleksionuar një tjetër triple-double në karrierë, me 42 pikë, 10 rebounde dhe 12 asistime, por në fund buzëqeshi Giannis Antetokounmpo i cili arriti shifrat e dyfishta në çdo aspekt të lojës duke e mbyllur ndeshjen me 33 pikë, 11 rebounde dhe 11 asistime.

SHKURT

Koeman: Gara për titull do të jetë e hapur deri në javën e fundit

Ronald Koeman beson se gara për titullin në La Liga do të zgjasë deri në javën e fundit. Skuadra katalanase për momentin mban vendin e tretë në tabelën e renditjes, 7 pikë larg nga Atletico kryesues. "Blaugranat" do ta sfidojnë Huescan të hënën në mbrëmje për të ngushtuar më shumë diferencën. "Kam thënë gjithmonë se do të jetë një sezon i gjatë. Pikët për Atletico në pjesën e parë të sezonit nuk ishin normale. Ata janë të fortë dhe shumë efektivë. Pasi humbëm në transfertën ndaj Cadizit, kemi shumë për të mësuar. Gara për titullin mund të shkojë deri në javën e fundit dhe do të jetë shumë e vështirë për ne, Atletico dhe Real Madridin. Skuadra jonë ka shumë potencial sepse kemi shumë kualitet që mund të ndryshojnë gjërat. Flitet shumë për të rinjtë, por duhet ta theksojmë cilësinë, përkushtimin dhe energjinë e lojtarëve më të vjetër si Leo [Messi], [Sergio] Busquets, [Jordi] Alba, Sergi Roberto, [Gerard] Pique ... Në përgjithësi ekipi ka shumë potencial", ka deklaruar Koeman.

Vdes ish-kampioni i botës

Ish-kampioni i padiskutueshëm i botës në peshat e mesme, Marvin Hagler, ka vdekur në moshën 66-vjeçare. Familja e tij njoftoi se ai vdiq papritmas. Amerikani mbizotëroi në divizionin e kategorisë së mesme nga viti 1979 deri kur pësoi humbje nga Sugar Ray Leonard në prill të vitit 1987. "Fatkeqësisht, bashkëshorti im Marvelous Marvin vdiq papritmas në shtëpinë e vet këtu në New Hampshire", ka thënë bashkëshortja e tij Kay Hagler. Hagler i zhvilloi 67 luftëra gjatë karrierës së vet profesionale që zgjati 14 vjet. Ai i fitoi 62 prej tyre, 52 me nokaut, ndërsa barazoi në dy të tjera dhe u mposhtur tri herë. Hagler e mbrojti titullin suksesshëm plot 12 herë dhe e fitoi në mënyrë të famshme luftën klasike të njohur si "lufta" kur e mposhti Thomas Hearnsin në prill të vitit 1985.

Bayerni shumë afër marrëveshjes me Saulin

Bayern Munchen duket se është pa frena në merkaton e verës dhe pasi ka siguruar shërbimet e Dayot Upamecanos, është shumë pranë një tjetër goditjeje të bujshme. Sipas mediave në Gjermani, "bavarezët" kanë ofruar 40 milionë euro për Saul Niguez dhe janë shumë pranë nënshkrimit me mesfushorin. Spanjoli është i zhgënjyer në Madrid, pasi prej kohësh nuk ka qenë një titullar fiks i formacionit të Diego Simeones dhe ka kërkuar largimin. Bayerni ka përfituar nga kjo situatë e krijuar dhe është shumë pranë transferimit të Saulit, i cili ka qenë një dëshirë edhe e Manchester Unitedit, por duket se kalimi në Gjermani e tërheq më shumë 26-vjeçarin.

Finalja e Kupës në Angli do të zhvillohet me tifozë

Më në fund do të ketë një ndeshje futbolli me 20 mijë tifozë të pranishëm në shkallët e stadiumit. Qeveria angleze ka marrë vendim që finalja e Kupës FA të zhvillohet me tifozë të pranishëm në stadium. Megjithatë, stadiumi legjendar anglez "Wembley" nuk do të jetë i stërmbushur, pasi vetëm 20 mijë tifozë do të lejohen të futen brenda. "Wembley" ka një kapacitet për 90 mijë tifozë, por në ndeshjet e futbollit aty lejohen vetëm 86 mijë persona të pranishëm. Gjithsesi finalja e madhe e Kupës FA që do të zhvillohet me praninë e shikuesve, do t'i hapë dyert për vetëm 20 mijë tifozë më 15 maj. Aktualisht kjo garë ka arritur deri në çerekfinale, ku Evertoni, Manchester City, Bournemouthi, Southamptoni, Leicester City, Manchester Unitedi, Barnsley dhe Chelsea janë pjesë e saj. Gjithsesi ky vendim është pritur jashtëzakonisht mirë nga tifozët, derisa finalja e Kupës FA do të jetë ndeshja me më së shumti tifozë në Angli që nga marsi i vitit të kaluar kur shpërtheu pandemia Covid-19.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjizë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhësi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 dhe 67 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Rregullores nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rregullores nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendeve të lira të punës

1. KQZ- 01/2021 Zyrtar i Lartë i Listës Votuese (rishpallje)

Grada/Koeficienti: Niveli Profesional- G6 -13.5
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Udhëheqësi i Divizionit të Shërbimit Votues
Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese 1(një) vjeçare
Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

- 1.Ndihmon në krijimin dhe mirëmbajtjen e listës së votuesve;
- 2.Mbështet vënien në zbatim të të gjitha operacioneve të shërbimit të votuesve në terren;
- 3.Ofron ndihmë profesionale për krijuesit e bazës së të dhënave;
- 4.Implementon Operacionet e Votimit përmes Postës dhe Votimin e personave me nevojë të veçanta;
- 5.Së bashku me Udhëheqësin e Divizionit të Shërbimit të Votuesve, mbikëqyrë shtypjen e listës përfundimtare të votuesve dhe listës komunale të votuesve;
- 6.Ndihmon në hartimin dhe menaxhimin e projekteve që lidhen me shërbimin e votuesve;
- 7.Detyra dhe përgjegjësi të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

- 1.Të ketë Diplomë Universitare në Drejtësi, Shkenca Politike, Administratë Publike, Inxhinieri kompjuterike dhe Statistika;
- 2.Së paku katër (4) vite përvojë pune.
- 3.Integritet të lartë personal dhe profesional;
- 4.Shkathësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
- 5.Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
- 6.Njohja e gjuhës tjetër zyrtare e dëshirueshme;
- 7.Njohje e gjuhës angleze e dëshirueshme;
- 8.Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access).

2.KQZ- 02/2021 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë

Grada/Koeficienti: Niveli Profesional- G6 -13.5
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Drejtori i Departamentit të Koordinimit në Teren

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, pas periudhës provuese 1(një) vjeçare

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

- 1.Kryeson Komisionin Komunal Zgjedhor në bashkëpunim të plotë me Sekretariatit e KQZ –së;
- 2.Përkujdeset për zbatimin e aktiviteteve dhe të gjitha akteve normative të nxjerra nga KQZ dhe Sekretariati në komunën përkatëse;
- 3.Mbikëqyrë dhe u cakton detyra anëtarëve të tjerë të KKZ –së;
4. Mbikëqyrë punën e trupave zgjedhore në komunën përkatëse;
5. Bën raporte për aktivitetet në periudhën zgjedhore dhe jo zgjedhore;
6. Koordinon aktivitetet në mes KKZ-së dhe Administratës Komunale dhe SKQZ-së;
7. Procedon në SKQZ kërkesat e Kuvendit Komunal për zëvendësimet e këshilltarëve komunal;
8. Ndihmon dhe këshillon subjektet politike dhe organizatat joqeveritare për zgjedhje;
9. Kryen detyra të tjera kur i caktohen nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

- 1.Të ketë diplomë universiteti në lëmin e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike, shkencave politike, të drejtave të njeriut, administrim të zgjedhjeve, shkencave sociale, marrëdhënie ndërkombëtare, menaxhment ose në statistikë;
- 2.Së paku katër (4) vite përvojë pune;
- 3.Integritet të lartë personal dhe profesional;
- 4.Shkathësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në njërën nga gjuhët zyrtare;
- 5.Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
- 6.Njohja e gjuhës tjetër zyrtare konsiderohet si përparësi;
- 7.Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
- 8.Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access);

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës,, Rruga "Migjeni" 10000 Prishtinë. Aplikacionet mund të dorëzohen edhe në formë elektronike të skenuara në adresën elektronike: zyra.personeli@kqz-ks.org.

Për informata të hollëshme, mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557, prej orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: www.kqz-ks.org. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni, certifikatën që nuk jeni nën hetime si dhe dy formularët e fundit të vlerësimit nga institucioni ku keni punuar.

Kandidatët për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve (ZLKZ) duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunat e tyre përkatëse.

Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose nëpërmjet telefonit nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor, prej datës: 15.03.2021 deri me datë: 29.03.2021 në ora 16:00. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Na osnovu članova 66. i 67. Zakona br.03/L-073 o Opštim izborima u Republici Kosovo, Uredbe br.01/2017 o Unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Sekretarijatu Centralne Izborne Komisije, Uredbe br. 03/2017 o Procedurama regrutacije, imenovanja i probnom radu u Sekretarijatu Centralne Izborne Komisije, Sekretarijat Centralne Izborne Komisije raspisuje:

KONKURS Za popunjavanje slobodnih radnih mesta

1. CIK- 01 /2021 Viši Službenik za Birački Spisak (ponovno raspisivanje)

Stepen/Koeficijent: Profesionalni Nivo- G6 - 13.5
Direktni Nadzornik: Rukovodioc Divizije za Usluge Birača
Trajanje imenovanja: Neograničeno, nakon jednogodišnjeg (1) probnog perioda
Mesto: Priština

Zadaci i odgovornosti radnog mesta

1. Pomaže u kreiranju i održavanju biračkog spiska;
2. Podržava sprovođenje svih operacija usluga birača na terenu;
3. Pruža profesionalnu pomoć kreatorima baze podataka;
4. Sprovodi Operacije glasanja putem pošte i Glasanja osoba s posebnim potrebama;
5. Zajedno sa Rukovodiocem Divizije za Usluge Birača vrši nadgledanje štampanja konačnog biračkog spiska i opštinskog biračkog spiska;
6. Pomaže u sastavljanju i upravljanju projektima vezanim za uslugu birača;
7. Obavlja i druge zadatke i dužnosti koje mu odredi nadzornik.

Kvalifikacije, Sposobnosti i radno iskustvo

1. Univerzitetska diploma u oblasti Prava, Političkih Nauka, Javne Administracije, Komjuterske inženjerije i Statistike;
2. Najmanje četiri (4) godine radnog iskustva.
3. Visok lični i profesionalni integritet;
4. Odlične veštine usmene i pisane komunikacije na službenim jezicima;
5. Sposobnost i spremnost da rade nepristrasno i sa ljudima različite etničke pripadnosti;
6. Poznavanje drugog službenog jezika poželjno;
7. Pismeno i usmeno poznavanje engleskog jezika poželjno;
8. Poznavanje informativne tehnologije (MS Word, MS Excel i MS Access).

2.CIK- 02 /2021 Viši Opštinski Izborni Službenik u Mamuši

Stepen/Koeficijent: Profesionalni nivo - G6 -13.5
Direktni nadzornik: Direktor Odeljenja za Koordinaciju na Terenu
Trajanje imenovanja: Neodređeno, nakon jednogodišnjeg (1) probnog perioda

Glavni zadaci i odgovornosti radnog mesta:

1. Predsedava Opštinsku Izbornu Komisiju u potpunosti saradnji sa Sekretarijatom CIK-a;
2. Obezbeđuje sprovođenje aktivnosti i svih normativnih akata izdatih od strane CIK-a i Sekretarijata CIK-a u odgovarajućoj opštini;
3. Nadgleda i dodeljuje zadatke ostalim članovima OIK-a;
4. Nadgleda rad izbornih tela u svojoj opštini;
5. Sastavlja izveštaje o izbornom i ne-izbornom periodu;
6. Koordinira aktivnosti između OIK-a i Opštinske Administracije i SCIK-a;
7. Prosleđuje u SCIK zahteve Skupštine Opštine za zamenu odbornika Skupštine Opštine;
8. Pomaže i savetuje političke subjekte i nevladine organizacije za izbore;
9. Obavlja i druge zadatke i dužnosti koje mu odredi nadzornik.

Kvalifikacija, sposobnosti i radno iskustvo:

1. Da poseduje univerzitetsku diplomu iz oblasti prava, ekonomije, javne uprave, političkih nauka, ljudskih prava, izborne administracije, društvenih nauka, međunarodnih odnosa, menadžmenta ili statistike;
2. Najmanje četiri (4) godine radnog iskustva;
3. Visoki lični i profesionalni integritet;
4. Odlične sposobnosti u usmenom i pismenom izražavanju na jednom od službenih jezika;
5. Sposobnost i spremnost nepristrasnog rada sa ljudima različite etničke pripadnosti;
6. Poznavanje drugog službenog jezika smatra se prednost;
7. Poznavanje engleskog jezika poželjno;
8. Poznavanje informativne tehnologije (MS Word, MS Excel dhe MS Access);

Aplikacije se mogu preuzeti i predati u Sekretarijatu Centralne Izborne Komisije, Kadrovska kancelarija, kancelarija br.21, I-vi sprat, bivša zgrada Ljubljanske Banke, Ulica "Migjeni" 10000 Priština. Aplikacije se mogu predati i u elektronskom obliku na adresi: zyra.personeli@kqz-ks.org.

Za detaljnije informacije, možete stupiti u kontakt sa osobljem Kadrovske kancelarije na br. tel.: 038-200-23-557, od 08:00 – 16:00, ili posetite web-stranicu CIK-a, na linku: www.kqz-ks.org. Aplikacije poslate putem pošte, na kojima je poštanski pečat pošiljke sa datumom zadnjeg dana konkursa, će se uzeti u obzir i razmotriti, ukoliko iste pristignu u roku od 4 dana. Aplikacije koje pristignu nakon ovog roka i nekompletirane aplikacije se neće uzeti u obzir. Aplikaciji priložite kopiju dokumentacije o vašim kvalifikacijama, radnom iskustvom i ostalu neophodnu dokumentaciju koja se zahteva za ovo radno mesto za koje vi konkurirate, potvrda da niste pod istragom kao i dva zadnja obrasca vašeg ocenjivanja iz institucije u kojoj ste ranije radili.

Kandidati za položaj Višeg Opštinskog Izbornog Službenika (VOIS) treba da budu osobe sa pravom glasa iz odgovarajuće opštine. Kandidati koji uđu u uži izbor za intervju biće informisani pismeno ili putem telefona od strane kadrovske kancelarije. Kandidati koji budu izabrani za učesće na intervju dužni su da sa sobom ponesu originalna dokumenta. Rok konkursa je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi, od dana: 15.03.2021 – 29.03.2021 u 16:00 časova. Centralna Izborna Komisija pruža jednake mogućnosti za zapošljavanje svim građanima Kosova i podstiče prijave svih osoba muškog i ženskog roda, kao i pripadnika svih zajednica na Kosovu, uključujući osobe sa ograničenim sposobnostima.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

